

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A mund ta bëjë BE-ja Shqipërinë një vend më të aksesueshëm? - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/16/a-mund-ta-beje-be-ja-shqiperine-nje-vend-me-te-aksesueshem/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 05:00:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 04:42:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	defe4a9fd3fad84941ad3bbb1192c160a0e9f12f92cb519d0a8243d6652a082b
TEKSTI	39553645c88c3e866aad2a8e1b7d1d036ea29838dd0907200fe497a728cb2eef
PAMJA	1abed52d2fc5b0d49a6580567f2bc31f55af8447f6f4d4faa28d87872f179893

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a8624ecbd42a88883eeea4dafd46b32a682f811e90bc0289ad8e98fc8e265b30
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d9560e9dee7d667e4c0855efa59278dec1e8935faed252449ae9de5f9970896
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a8624ecbd42a88883eeea4dafd46b32a682f811e90bc0289ad8e98fc8e265b30>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Analiza

A mund ta bëjë BE-ja Shqipërinë një vend më të aksesueshëm?

Qeveria po përgatitet të përqafojë standardet e BE-së për personat me aftësi të kufizuar, por aktivistët paralajmërojnë se pa financim dhe mekanizma të fortë zbatimi, ligji i ri rrezikon të mbetet një tjetër premtime në letër.



nga Besa Likmeta — 13 seconds më parë në Analiza, Artikull kryesor, Artikull kryesor Analiza

Koha e leximit: 8 min lexim

AA 0



Një person me aftësi të kufizuara duke lëvizur me karrocë. Foto ilustruese nga Pixabay.

Katerina Jaupaj e kuptoi që e vogël se nuk mund t'i hidhte hapat pa menduar për pasojat. Ishte vetëm një vjeç e gjysmë dhe sapo kishte filluar të ecte kur theu këmbën për herë të parë.

Më vonë, mjekët e diagnostikuan me *osteogenesis imperfecta*, një çrregullim i rrallë gjenetik që ndikon në prodhimin e kolagjenit dhe i bën kockat veçanërisht të brishta. Të njohur shpesh si "fëmijët e qelqtë", personat me këtë sëmundje përballen me një rrezik të lartë frakturash edhe nga goditje apo lëvizje që për të tjerët do të ishin të zakonshme.

Frika nga dëmtimet e shoqëroi Katerinën gjatë gjithë fëmijërisë. Bashkëmoshatarët, të porositur nga prindërit e saj që të tregoheshin të kujdesshëm, e trajtonin "si princeshë", kujton ajo.

Rreth klasës së katërt, Katerina filloi të përdorte një karrige me rrota. Por mjeti që duhej t'i jepte më shumë liri në lëvizje u kthye shpejt në një burim tjetër ankthi. Në Patos, qytetin e vogël ku u rrit, ishte e vështirë të gjeje goma apo pjesë këmbimi për karrigen, ndërsa rampat në shkolla, institucione dhe hapësira publike pothuajse nuk ekzistonin. Për aksesueshmërinë, kujton Katerina, "thua se nuk bëhej fare fjalë".

Pavarësisht pengesave, Katerina vazhdoi shkollën, u zhvendos në Tiranë dhe shkoi në universitet. Sot në moshën 23-vjeçare, ajo punon në një agjenci publike për promovimin e politikave rinore dhe ndjek studimet master për Punë Sociale. Kryeqyteti i ofroi më shumë mundësi se qyteti ku u rrit, por jo domosdoshmërisht më shumë pavarësi.

Shumë nga barrierat mbetën të njëjta.

Në përpjekje për të garantuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, si dhe për të përfunduar legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale publikoi më 1 shtator për konsultim publik projektligjin "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

Projektligji transponon në legjislacionin shqiptar Aktin Evropian për Aksesueshmërinë dhe vendos standarde të reja për një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh, veçanërisht ato digjitale. Ai zgjeron gjithashtu detyrimet e institucioneve shtetërore dhe bizneseve private për të bërë produktet dhe shërbimet e tyre të aksesueshme.

A mund ta bëjë BE-ja Shqipërinë një vend më të aksesueshëm?

06:42 | 16/09/2026

Qeveria premton rritje pensionesh në prag të zgjedhjeve vendore

16:47 | 15/09/2026

Rama merr 245 aplikime për të punuar me "agjencinë e propagandës së regjimit"

13:08 | 15/09/2026

"Revanshi": Shtatë të pandehur dënohen me 50 vjet burg

12:51 | 15/09/2026

Gjykata e Lartë lë në fuqi arrestin me burg për Erion Veliajn

12:12 | 15/09/2026

E vërteta dhe pasojat: Gjykata Speciale e Kosovës drejt një vendimi me rëndësi vendimtare

11:17 | 15/09/2026

Udhëzime për prodhimet dhe shërbimet e tyre të aksesueshme.

Aktivistët e konsiderojnë projektligjin një hap të rëndësishëm drejt standardeve evropiane. Por hendeke mes ambicies së tij dhe realitetit në terren i bën skeptikë: a mund të kalojë Shqipëria te standardet e aksesueshmërisë digjitale, kur ende nuk ka arritur të garantojë aksesin fizik në ndërtesat publike dhe private?

“Është një hap pozitiv, por shumë i vështirë për t’u zbatuar,” tha Suela Lala, drejtuese e Fondacionit “Së Bashku”, duke nënvizuar se në Shqipëri ka ende spitale, qendra shëndetësore, shkolla dhe rrugë të paaksesueshme, ose rampa që nuk përbushin standardet bazë.

“Të kalosh nga këto mangësi të aksesueshmëria digjitale e bankave, bankomateve, dyqaneve dhe shërbimeve të tjera, publike dhe private, është një kapërcim shumë i madh,” shtoi ajo.

Barrierat fizike dhe institucionale

Sipas Censit të vitit 2023, 6.5 për qind e popullsisë shqiptare mbi pesë vjeç jeton me të paktën një aftësi të kufizuar, të përkufizuar nga INSTAT si pamundësi e plotë në të paktën një nga gjashtë funksionet bazë: shikimi, dëgjimi, ecja, përqendrimi, kujdesi për veten dhe komunikimi.

Aftësia e kufizuar lidhet fort me moshën. Gati 60 për qind e personave të identifikuar nga Censi janë mbi 65 vjeç, ndërsa prevalenca është më e lartë mes grave, 7.2 për qind, krahasuar me 5.9 për qind mes burrave.

Megjithëse personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, për shumë prej tyre pjesëmarrja e barabartë në jetën publike vazhdon të pengohet nga barrierat fizike dhe institucionale. Legjislacioni kërkon prej vitesh eliminimin e këtyre pengesave, por ndërtesat publike, shkollat, qendrat shëndetësore, rrugët dhe transporti mbeten shpesh të paaksesueshme. Edhe aty ku janë ndërtuar rampa, ato jo gjithmonë përbushin standardet bazë.

Për Katerina Jaupajn, një dalje e zakonshme nga shtëpia mund të shndërrohet shpejt në një varg pengesash. Sfidat mund të nisë te dera e pallatit, nëse godina nuk ka rampë apo ashensor, të vazhdojë në trotualet e ngushta e të bllokuara dhe të përfundojë përpara shkallëve të një banke, dyqani apo kafeneje ku ajo nuk mund të hyjë pa ndihmën e dikujt tjetër.

“Mund të nisë që nga pallati ku banon. Mund të mos ketë rampë dhe të mos kesh mundësi të dalësh vetë nga shtëpia. Pastaj vazhdon me rrugën, bankën, dyqanin e kështu me radhë,” tha 23-vjeçarja, e cila studion për master në Punë Sociale. “Edhe për të pirë një kafe, shpesh nuk mund të shkosh vetë. Duhet të kesh gjithmonë një shoqëruar.”

Në Tiranë, trotualet e zëna nga ndërtimet apo pengesa të tjera e detyrojnë shpesh Jaupajn të lëvizë me karrigen me rrota në të njëjtën hapësirë me makinat.

“Dhe aty, normalisht, rrezikon,” tha ajo.

Jaupaj e ka provuar edhe një realitet tjetër gjatë një periudhe që jetoi në Gjermani, ku infrastruktura e përshtatur, sipas saj, i dha mundësi të ishte shumë më pak e varur nga ndihma e të tjerëve. Ndryshimi ishte veçanërisht i dukshëm në transportin publik.

“Në Gjermani, autobusët dhe metrotë janë të përshtatura. Edhe nëse një person është vetëm, mund të lëvizë,” tha ajo. “Diferenca është shumë e madhe,” shtoi Jaupaj.

Të njëjtin hendeke sheh dhe Suela Lala, drejtuese e Fondacionit “Së Bashku”. Sipas saj, problemi kryesor nuk qëndron te mungesa e legjislacionit, por te dështimi për ta zbatuar atë, ndërsa vë re se, edhe vetë Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranon se një pjesë e institucioneve në varësi të saj vazhdojnë të jenë të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Ajo e cilëson ligjin ekzistues një “dështim total”, pasi më shumë se një dekadë pas miratimit, ndryshimet në terren mbeten të pakëta.

“Kur flasim për aksesueshmëri, shumica e njerëzve dhe institucioneve kuptojnë vetëm atë rampën në hyrje,” tha ajo. “Nuk kuptojnë elementët për personat që nuk shikojnë, mënyrën si mobilohet dhe organizohet mjedisi, tualetet e aksesueshme apo ndriçimin.”

Për të kapërcyer këtë hendeke mes ligjit dhe realitetit, organizatat e personave me aftësi të kufizuara kanë kërkuar ngritjen e një agjencie kombëtare që të monitorojë zbatimin e standardeve, të vendosë sanksione, por edhe të informojë institucionet shtetërore dhe subjektet private mbi detyrimet e tyre. Sipas saj, mangësitë shpesh dëshmojnë jo vetëm mungesë zbatimi, por edhe moskuptim të vetë konceptit të aksesueshmërisë.

Një hap përpara

Projektligji i ri synon të zëvendësojë ligjin nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", duke zgjeruar ndjeshëm detyrimet, veçanërisht për bizneset dhe ofruesit e shërbimeve.

Ndryshimi kryesor është kalimi nga një kuadër i përqendruar kryesisht te mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, drejt vendosjes së standardeve të detyrueshme për produkte dhe shërbime, në përputhje me Aktin Evropian të Aksesueshmërisë.

Në praktikë, kërkesat e reja do të prekin një gamë të gjerë produktesh teknologjike – nga kompjuterët, telefonat inteligjentë dhe pajisjet elektronike te bankomatet, terminalët e pagesave, makinat e biletave dhe kioskat elektronike. Detyrime të ngjashme vendosen për shërbimet bankare, transportin, komunikimet elektronike, mediat audiovizive, librat elektronikë, tregtinë online dhe shërbime të tjera digjitale.

Risia është se përgjegjësia nuk mbetet vetëm te institucionet publike. Prodhuesit, importuesit, distributorët dhe ofruesit privatë të shërbimeve duhet të sigurojnë aksesueshmërinë përgjatë gjithë ciklit të produktit ose shërbimit – nga projektimi dhe prodhimi deri te hedhja në treg dhe përdorimi nga konsumatori. Projektligji parashikon gjithashtu rregulla të reja për aksesueshmërinë në prokurimet publike dhe mundësinë e tërheqjes nga tregu të mallrave që nuk përmbushin kërkesat.

"Projektligji përbën një hap të rëndësishëm përpara," thotë Blerta Cani, drejtuese e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (ADRF), ndërsa shtoi se ndryshe nga ligji aktual ai vendos detyrime konkrete për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve dhe e shtrinë më qartë këtë përgjegjësi edhe te sektori privat, nga bankat dhe bankomatet te tregtia elektronike, transporti dhe komunikimet. "Sfida kryesore mbetet kalimi nga parimet në zbatim," shtoi ajo.

Një tjetër ndryshim lidhet me kontrollin dhe sanksionet. Mbikëqyrja ndahet mes disa ministrive dhe institucioneve rregullatore, përfshirë Bankën e Shqipërisë, AKEP-in dhe AMA-n. Projektligji zgjeron gjithashtu konceptin e jetesës së pavarur, duke parashikuar asistencë personale, vendimmarrje të mbështetur dhe financim për mjete ndihmëse. Personit me aftësi të kufizuara i njihet një rol më i madh në zgjedhjen dhe menaxhimin e mbështetjes që merr, përfshirë zgjedhjen dhe udhëzimin e ndihmësit personal.

Sistemi i ri parashikon shqyrtimin e ankesave, kontrole periodike dhe masa korrigjuese, ndërsa gjomat mund të arrijnë deri në 5 milionë lekë ose në 0.1 për qind të xhiros vjetore për shoqëritë tregtare.

"Kjo qasje shfrytëzon ekspertizën e institucioneve sektoriale, por kërkon koordinim të fortë, kapacitete teknike dhe një mekanizëm të thjeshtë e të aksesueshëm për paraqitjen e ankesave," tha Cani.

Ajo shtoi se masat konkrete të gjobave, afatet që do t'u lihen operatorëve për korrigjimin e shkeljeve dhe raportimi publik mbi kontrollin duhet të përcaktohen qartë, në mënyrë që ligji të zbatohet nëse nga institucionet e ndryshme.

Edhe sistemi i vlerësimit për personat me aftësi të kufizuara ndryshon drejt një qasjeje multidisiplinare, ku nuk merret parasysh vetëm gjendja shëndetësore e individit, por edhe barrierat sociale dhe mjedisore që kufizojnë pjesëmarrjen e tij. Institucionet qendrore dhe vendore ngarkohen të planifikojnë gradualisht fonde për eliminimin e pengesave në shërbimet publike, ndërsa personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre u forcohet roli në konsultimin dhe monitorimin e politikave.

"Standardet specifike dhe një pjesë e procedurave do të përcaktohen me akte nënligjore brenda 18 muajve," shpjegoi Cani. "Prandaj është e rëndësishme që këto akte të hartohen në kohë dhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre," shtoi ajo.

Kosto të paqarta

Projektligji për aksesueshmërinë vjen në kohën kur Shqipëria ka përsheptuar përafrimin e legjislacionit vendas me direktivat dhe standardet e Bashkimit Evropian, si pjesë e negociatave të anëtarësimit. Ritmi i ri po sjell standarde më të larta në legjislacion, por njëkohësisht po ngrë pikëpyetje mbi kostot dhe kapacitetet e vendit për t'i zbatuar ato në praktikë.

Gledis Gjipali, drejtor ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri (EMA), vlerëson se presioni për të përmbyllur afatet e negociatave nuk është shoqëruar me të njëjtën intensitet nga debati mbi faturën financiare që përafrimi do të ketë për shtetin, bizneset dhe qytetarët.

"Procesi po zhvillohet kryesisht nën presionin e afateve për përafrimin formal të legjislacionit, ndërsa debati publik dhe vlerësimet e konsoliduara mbi kostot e këtij procesi për institucionet, biznesin dhe qytetarët mbeten shumë të kufizuara," tha Gjipali.

Sipas tij, analizat e ndikimit dhe përllogaritjet financiare që shoqërojnë ligjet e reja shpesh

mungojne ose nuk arrijne te pasqyrojne pnotesisnt investimet qe do te kerkonen ne infrastrukturë, burime njerëzore dhe përshtatjen e bizneseve.

"Rreziku është që shpejtësia e miratimit të ligjeve të mbizotërojë ndaj kapacitetit për zbatimin e tyre real," shtoi Gjipali. "Përbushja e standardeve të BE-së kërkon jo vetëm legjislacion të harmonizuar, por edhe mjete financiare, institucione funksionale dhe kohë të mjaftueshme përshtatjeje", theksoi ai.

Projektligji i ri për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara e vendos këtë dilemë në terma konkretë. Ai synon të sjellë në legjislacionin shqiptar kërkesat e Aktit Evropian për Aksesueshmërinë, duke vendosur detyrime të reja për institucionet publike dhe një gamë të gjerë operatorësh privatë. Por ndërsa standardet që duhet të arrihen janë përcaktuar, fatura e zbatimit mbetet e paqartë.

Një prej sektorëve që pritet të preket drejtpërdrejt është ai bankar, ku kërkesat e reja shtrihen nga bankomatet te shërbimet dhe kanalet digjitale. Por ndërsa projektligji është ende në konsultim, bankat nuk kanë një përllogaritje të kostos së përshtatjes.

Spiro Brumbulli, sekretar i përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, tha për BIRN se sektori është ende duke shqyrtuar kërkesat e projektligjit.

"Jemi në fazën e shqyrtimit dhe diskutimit me bankat," theksoi ai.

Blerta Cani vëren se relacioni që shoqëron projektligjin e pranon nevojën për financim, por nuk tregon se sa do të kushtojë zbatimi. "Projektligji e pranon se zbatimi do të kërkojë financim dhe parashikon mbështetje nga Buxheti i Shtetit dhe planifikim në programet buxhetore afatmesme, por në relacionin e publikuar nuk paraqitet shifra e kostos totale," tha ajo, ndërsa shtoi se dokumenti thotë se kostot janë përllogaritur në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit. "Në fund suksesi i ligjit do të varet nga aktet nënligjore, buxheti dhe monitorimi i vazhdueshëm", përfundoi Cani.

Etiketa: Akti European per Aksesueshmerine Bashkimi European Blerta Cani Gledis Gjipali Katerina Jaupaj Personat me aftësi të kufizuara Spiro Brumbulli Suela Lala

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakttoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Slida.PRO